

Përse dëshirojmë ta organizojmë Gjykatën e Grave?

Sepse sistemi institucional ligjor nuk e plotëson kërkesën e drejtësisë as në nivelin ndërkombëtar e aq me pak në atë kombëtar; kjo sidomos vlen për shtetet e ish Jugosllavisë ku elita politike bënë shume përpjekje për ta shmangur drejtësinë, apo sakrifikon drejtësinë për interesat politikedhe mbajtjen e pushtetit.



Sepse përmes *Gjykatës së Grave*, gratë bëhen subjekt i drejtësisë, e inkurajojnë krijimin e praktikave të ndryshme ligjore, ndikojnë në sistemin-institucional ligjor.



Sepse *gjykata e Grave* është hapësirë/vend për votat e grave, për dëshmitet e grave lidhur me përvojat e përditshmetë padrejtësive të përjetuara gjatë luftës dhe tani, në paqe; në Gjykatën e Grave, gratë dëshmojnë për dhunën në sferën publike dhe private.



Sepse *Gjykata e Grave* inkurajon forcimin e rrjeteve të mbështetjes reciproke dhe solidaritetit me qëllim të krijimit të lëvizjes së fortë autonome të grave.



Sepse *Gjykata e Grave* inkurajon krijimin e konceptit feminist të përgjegjësisë, kujdesit, sigurisë për të ndërtuar paqe.

Çfarë dëshirojmë të arrijmë me organizimin e Gjykatës së Grave?

Inkurajojmë gratë që të dëshmojnë për të gjitha llojet e padrejtësisë strukturore: varfërisë, shfrytëzimin në vendin e punës dhe kudo tjetër, veprimin brutal, të pa ndërhyrë dhe të pakufizuar të tregut, kërcënimit social dhe shëndetësor, keqpërdorimin i religjionit për qëllime politike...



Krijojmë historinë alternative të shkruar: si me publikimin e përvojave të deritanishme në punën e Gjykatës dhe tribunalit të Grave, ashtu edhe në publikimin e përvojave tona në punën e organizimit të gjykatës së Grave në ish Jugosllavi;



Përforcojmë koalicionet dhe aleancat globale feministo-pacifike; për të dënuar dhunën dhe krimin, për të ndikuar në institucionet ndërkombëtare të drejtësisë me qëllim të sjelljes së dokumenteve dhe rezolutës të bazuar në përvojat e përditshme të padrejtësisë ndaj grave dhe të gjithë atyre që kanë fuqinë e vogël shoqërore, ekonomike dhe politike.

Çfarë aktivitete organizojmë për të mirëmbajtur Gjykatën e Grave?

Puna edukative në terren: seminarët, punëtoritë, konferencat, tavolinat e rrumbullakëta...

Puna hulumtuese në terren të karakterit interaktiv: për t'i mbledhur informacionet, propozimet, sugjerimet, në lidhje me konceptin dhe vizionin e drejtësisë, ashtu edhe për përzgjedhjen e temave në Gjykatën e Grave.

Krijojmë thelbin e përkrahjes ndaj Gjykatës së Gruas: të ashtuquajtura grupe kyçe në kuadër të koalicioneve të aktivisteve OJQ, media, shoqatat e artisteve dhe artisteve, institucionet.

Prezantimet publike të iniciativave për gjykatat e grave të organizuar në ish Jugosllavi.

Projeksionet e filmave dokumentar për përvojat e gjykatave të Grave në nivelin ndërkombëtar si dhe për përvojat e grupeve dhe rrjeteve të grave në lidhje me qasjen feministe në drejtësi.

Ngjarjet artistike: shfaqjet teatrale, ekspozitat, performancat...

Iniciojmë ueb faqen dhe biltenin mbi përvojat e punës në organizimin e Gjykatës së Gruas.

Organizojmë Gjykatën e Grave në vendet e ish Jugosllavisë - vend për dëshmimin dhe votat e grave, për autonominë e grave nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në ndërtimin e drejtësisë dhe paqes, për të krijuar paradigmat e reja të drejtësisë.

Historiku i iniciativës për organizimin e Gjykatës së Grave në ish-Jugosllavinë

Aktivistet nga shoqëria civile të organizatave që përbëjnë Bordin Drejtues për Gjykatën e Grave në ish-Jugosllavinë, që nga fillimi i luftërave (1991) kanë qenë më aktive në rezistencën ndaj luftës, nacionalizmit, homogjenimit etnik, militarizmit. Pavarësisht nga pengesat dhe kufizimet të cilat janë Imponuar regjimit nationalist-militarist, aktivistet kanë ruajtur në vazhdimësi bashkëpunimin, kanë krijuar rrjetet paqësore jashtë kufijve etnik dhe ndarjeve. Pas luftërave, aktivistet e shoqërisë civile – mbrojtëse e drejtave të njeriut, të lëvizjes paqësore autonome të grave, kanë qenë më aktive në aktivitetet e dënimit të dhunës, ndihmës dhe përkrahjes ndaj viktimave të krimeve të luftës, në aktivitetet kundër mohimit të krimit, relativizimit të krimit nga e kaluara e largët, si dhe në krijimin e modelit feminist të drejtësisë tranzicionale.

Në fund të vitit 2010, anëtarët e Bordit Drejtues në përbërje nga: Gratë për Gratë, Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë), Qendra për edukim paqësor dhe të grave Anima nga Kotori (Mal i Zi), Qendra për Studime të Grave dhe Qendra për Gratë Viktimat e Luftës, nga Zagrebi (Kroacia), Rrjeti i Grave të Kosovës, Studimet e grave dhe Gratë në të Zeza nga Beogradi, kanë nisur një iniciativë të përbashkët për të organizuar Gjykatën e Grave në ish-Jugosllavinë.

Gratë në të Zeza janë mbajtëse e aktiviteteve të programit në organizimin e Gjykatës së Grave, organizojnë dhe i koordinojnë të gjitha aktivitetet me organizatat që përbëjnë Bordin Drejtues.

Qasja Feministe në drejtësinë tranzicionale e Grave në të Zeza

Që nga fillimi i punës së tyre, për Gratë në të Zeza kjo pyetje paraqet një nga segmentet më të rëndësishme të politikës së paqes.

Qasja feministe në drejtësinë tranzicionale nuk është një mohim i modeleve ekzistuese të drejtësisë tranzicionale dhe mekanizmave institucional të drejtësisë, por do të thotë të menduarit e tyre dhe përfshirja e dimensionit gjinor në teorinë dhe praktikën e drejtësisë, dhe mbi të gjitha krijimi i modeleve të reja të drejtësisë.



Gratë në të Zeza

Jug bogdanova 18/5, Beograd

+381 11 26 23 225

zeneucrn@gmail.com

www.zeneucrn.com

Zbatuar me ndihmën financiare
Mama Cash



GJYKATA E GRAVE PËR ISH JUGOSLLAVINË